

Tiranë, më __28__._05_.2020

K Ë R K E S Ë

NGA: **Qëndresa Qytetare**, një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me Vendimin Nr. 1120, datë 15.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Sheshi “Avni Rustemi”, Rruga “Hoxha Tahsim”, Pallati “Vjero”, Ap. A17, Tiranë, me email: qendresaqytetare@gmail.com dhe nr. cel: (+355) 69 22 03 074, përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv **Rigels Xhemollari** dhe këshilltari ligjor **Marash Logu**.

LËNDA: Kërkesë për përgjysmimin e tarifave të studimit për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve të Universitetit të Tiranës për vitin akademik 2019 – 2020.

BAZA LIGJORE: Nenet 3 dhe 7 të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”;
Nenet 7 dhe 31 të Statutit të Universitetit të Tiranës.

DREJTUAR: **Znj. Besa SHAHINI**
Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

PËR DIJENI: **Z. Mynyr KONI**
Rektor i Universitetit të Tiranës

Z. Skerdi DAFA
Administrator i Universitetit të Tiranës

Znj. Fatjona DHIMITRI
Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Znj. Erinda BALLANCA
Avokat i Popullit

E nderuar Znj. Shahini,

Në datën 26 Maj 2020, një grup studentësh të Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës i janë drejtuar me një kërkesë Qëndresës Qytetare, nëpërmjet të cilës kërkojnë që të informojmë Ministrinë e Arsimit dhe institucionet e tjera kompetente lidhur me vështirësitë ekonomike që ata po kalojnë për shkak të gjendjes së pandemisë COVID-19. Në këtë kërkesë, studentët shpjegojnë se situata e pandemisë ka pasur një impakt të drejtpërdrejtë në ekonominë e familjeve të tyre, si dhe se aktualisht ata janë duke marrë një minimum shërbimesh nga universiteti për shkak të distancës fizike.

Nisur nga kjo kërkesë e studentëve, si një organizatë jofitimprurëse e angazhuar prej katër vitesh në çështjet e arsimit të lartë, po paraqesim këtë kërkesë për përgjysmimin e tarifave të studimit për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2019 – 2020.

Neni 3 i ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” parashikon se “*Autonomia financiare garantohet nëpërmjet të drejtës për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj.*” Ndërsa, neni 7 parashikon se “*Ministria përgjegjëse për arsimin i propozon Këshillit të Ministrave kufirin maksimal të tarifës së shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë në institucionet publike të arsimit të lartë.*” Me Vendimin Nr. 288, datë 21.05.2018, Këshilli i Ministrave ka miratuar kufirin maksimal të tarifave vjetore të shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë në universitetet publike, të cilat variojnë nga 20 000 deri 45 000 lekë. Ndërsa, për tarifat e studimit të ciklit të dytë, ligji nuk parashikon asnjë kufi. Sipas një studimi të kryer nga Qëndresa Qytetare, tarifat e studimit të ciklit të dytë variojnë nga 60 000 – 233 000 lekë.

Neni 7 i Universitetit të Tiranës parashikon se “*Autonomia financiare e UT garantohet nëpërmjet të drejtës për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.*” Ndërsa, neni 31 parashikon se “*Senati Akademik i propozon Bordit të Administrimit tarifat e studimit të studentëve.*” Pra, pasi Këshilli i Ministrave ka miratuar kufirin maksimal të tarifave për studentët e ciklit të parë të studimeve, Senati Akademik i propozon Bordit të Administrimit tarifat e studentëve për secilin program studimi për të dyja ciklet. Bordi i Administrimit vendos mbi propozimin e bërë nga Senati Akademik.

Neni 17 i ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” dhe neni 144 i Statutit të Universitetit të Tiranës parashikojnë se Universiteti i Tiranës financohet nga

Buxheti i Shtetit, pagesat e studentëve, të ardhurat për shërbime, të ardhurat nga marrëdhëniet me të tretët, veprimtari kërkimore-shkencore, projekte të ndryshme, donacione dhe çdo burim tjetër i ligjshëm financimi.

Me Urdhërin Nr. 156/2, datë 11.03.2020, Ministri i Shëndetësisë ka shpallur gjendjen e epidemisë nga infeksioni COVID-19. Ndërsa, me Vendim Nr. 243, datë 24.03.2020, Këshilli i Ministrave ka vendosur shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Këto akte janë shoqëruar me një sërë masash që kanë sjellë mbylljen e institucioneve arsimore, kufizimin e lëvizjes, mbylljen e aktivitete ekonomike. Masa të tilla kanë sjellë vështirësi ekonomike për shumë familje shqiptare, të cilat kanë humbur apo iu janë reduktuar në një mënyrë të konsiderueshme të ardhurat e tyre.

Kriza ekonomike që ka shkaktuar gjendja e pandemisë COVID-19 ka prekur drejtpërdrejtë edhe studentët. Këta të fundit, pavarësisht se prej thujse tre muajsh nuk frekuentojnë ambientet e universiteteve dhe marrin një numër minimal shërbimesh, vecse për aq sa është e mundur të merren online, duhet të paguajnë tarifën e plotë të studimit. Për një pjesë të madhe të tyre që nuk jetojnë në Tiranë, edhe pse janë kthyer në shtëpitë e tyre, sërish iu duhet të paguajnë qiranë e shtëpive qoftë për shkak të pamundësisë për të marrë sendet e tyre personale për shkak të kufizimit të lëvizjeve, apo edhe për shkak se duke qenë të paqartë për kohën kur duhet të ktheheshin në universitet, kanë vazhduar të paguajnë qiranë e shtëpive.

Kjo situatë ka prekur vecanërisht studentët e ciklit të dytë të studimeve (master), të cilët filluan studimet në muajin Nëntor 2019. Për shkak të tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, shkolla u ndërpre për një afat dy javor. Më pas, ishin pushimet e fundvitit dhe në Mars 2020 do të ndërprisnin frekuentimin e universitetit deri më tani. Praktikisht, studentët e masterit kanë frekuentuar universitetin vetëm për një periudhë të shkurtër në Janar – Shkurt 2020. Megjithatë, ata do të duhet të paguajnë tarifën e plotë të studimit, të cilat sic kemi shpjeguar më lart variojnë nga 600 000 – 233 000 lekë. Shuma të tilla, të konsiderueshme, i vendosin studentët dhe familjet e tyre në vështirë të mëdha ekonomike për përballimin e tyre. Aq më shumë kur kësaj tarife i shtohet edhe qiraja e banesës apo shpenzime të tjera. Në auditimin e kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në datën 20.12.2018 mbi “Cilësinë dhe tarifimin e shërbimeve studentore pranë IAL-ve publike” konstatohet se tarifat e shkollimit janë të vendosura jo mbi bazën e analizës së kostove dhe kushteve social-ekonomike të vendit. Për këtë arsye, KLSH

rekomandonte që tarifat të jenë një reflektim i kostove, por edhe kushteve social-ekonomike të Shqipërisë. Në rastin konkret, tarifat e studimit duhet të jenë reflektim i faktit se gjatë këtyre tre muajve, studentët, vecanërisht studentët e ciklit të dytë, kanë marrë një nivel minimal shërbimesh. Nga ana tjetër, tarifat duhet të marrin në konsideratë edhe faktin se prej tre muajsh, familjet shqiptare po përballen me një krizë të shumëanshme.

Në këto kushte, Ministria e Arsimit dhe Universiteti i Tiranës, në ushtrim të kompetencave të tyre ligjore dhe statuore, duhet të marrin masat e nevojshme për të lehtësuar pasojat ekonomike që ka prodhuar gjendja e pandemisë nga data 11 Mars e në vijim në vendin tonë. Konkretisht, ne vlerësojmë se masa më e përshtatshme do të ishte përgjysmimi i tarifave për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2019 – 2020. Efekti financiar që do të kishte ky vendim në buxhetin e Universitetit të Tiranës, mund të rimbursohet pjesërisht nga Buxheti i Shtetit dhe pjesërisht nga buxheti i UT.

Një vendimmarrje e tillë do të duhet të shtrihet më pas edhe në universitetet e tjera publike, studentët e të cilëve përballen me të njëjtat probleme apo probleme të ngjashme.

Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, bazuar në nenet 3 dhe 7 të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 7 dhe 31 të Statutit të Tiranës, kërkojmë përgjysmimin e tarifave për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2019 – 2020.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të përgjigjes Tuaj.

Me konsideratë,

QËNDRESA QYTETARE

Rigels XHEMOLLARI

(Rigels Xhemollari)



Marash LOGU

(Marash Logu)